



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Nr. 1968/2 Prot.

Tiranë, më 11.10.2022

V E N D I M

Nr. 28/11 datë. 11.10.2022

**PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË Znj. LORANA KASAPI NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NË DATËN 30.09.2021.**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Z. Besnik Maho - Kryetar  
Znj. Joana Asimi – Anëtar  
Z. Julian Zonja - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Alma Zili  
Znj. Eljona Bylykbashi  
Znj. Jetmira Saraçi

Në mbledhjen e datës 10.10.2022, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit inspektor jomagjistrat

**Znj. LORANA KASAPI**

**OBJEKTI:**

**Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së Znj. Lorana Kasapi në vendin vakant për Inspektor jo magjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.**

## KOMITETI PASI :

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 30.09.2021, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 9 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 29.10.2021, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 08.11.2021, ku vendosi për radhën e shqyrtimit të dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave/zhvillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit".

4. Në zbatim të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimeve dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pasi zhvilloi procedurat e verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore për pozicionin e inspektorit, në mbledhjen e datës 07.07.2022, vendosi lejimin e kandidimit për pozicionin e inspektorit jomagjistrat për Znj. Lorana Kasapi dhe me komunikimin e datës 14.09.2022, njoftoi kandidatët për fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve.
  
5. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve me vendimin nr.28, datë 07.07.2022 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Lorana Kasapi për Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, hartoi relacionin e vlerësimit të këtij kandidati.
  
6. Sipas kalendarit të intervistave të miratuar, në 21.09.2022 dhe 22.09.2022, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit, për 9 (nëntë) vendet vakante.
  
7. Intervista mbi motivimin e kandidimit, Znj. Lorana Kasapi, kandidati për të 9 (nëntë) vendet vakante në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, u zhvillua në datën 22.09.2022.

## **II. Vlerësimi i Komitetit**

8. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Komitetit, si edhe

shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Komiteti ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit Lorana Kasapi për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara në shpjegimet e hollësishme të metodologjisë mbi të cilën bazohet vlerësimi dhe pikëzimi, miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përkatësisht:

## **1. Meritat profesionale - (50) pikë**

### **A. Historiku Arsimor dhe Profesional - (10) pikë**

9. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Lorana Kasapi, disponon këto të dhëna:

- Jurist, Telekomit Shqiptar, për periudhën 01 Prill 1998 – 22 Gusht 2000;
- Specialist në Departamentin Juridik, Albtelecom sh.a, për periudhën 23 Gusht 2000 - 04 Shkurt 2003;
- Kryetar në Departamentin Juridik Albtelecom sh.a. për periudhën 05 Shkurt 2003 – 31 Maj 2006;
- Avokat Shteti, pranë Zyrës Vendore Tiranë, Avokatura e Shtetit, për periudhën 02 Nëntor 2007 – 02 Gusht 2013;
- Avokat Shteti, pranë Ministrisë së Integritimit, Avokatura e Shtetit, për periudhën 02 Gusht 2013 - 27 Janar 2014;
- Avokat Shteti, në pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektimit, Avokatura e Shtetit, për periudhën 27 Janar 2014 – 10 Shkurt 2014;
- Avokat Shteti, në Zyrën e Përfaqësimit Ligjor në Gjykatat Kombëtare, Avokatura e Shtetit, për periudhën 10 Shkurt 2014 – 14 Shkurt 2018;
- Specialist, Drejtoria e Çështjeve, Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për periudhën 31 Gusht 2018 – 31 Dhjetor 2018;
- Specialist, Drejtoria Juridike, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për periudhën 03 Janar 2019 - 31 Dhjetor 2019;
- Këshilltar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për periudhën 03 Janar 2020 - deri në datën e paraqitjes së aplikimit.

#### **a. Historiku Arsimor - (2) pikë**

10. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së **arsimit të lartë juridik** me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.
11. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Lorana Kasapi:
- Ka përfunduar Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në periudhën 1996, duke u diplomuar “*Jurist*”. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës , rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare 9.3.
12. Prandaj, Komiteti vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlershëm me të, secilin kandidat sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.
13. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare 9.3, e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Komitetit çmoi ta vlerësojë kandidatin **Lorana Kasapi** me **2 (dy) pikë**.

## **b. Kualifikime Pasuniversitare - (5) pikë**

### **b.1 Studimet pasuniversitare - (1/5) pikë**

14. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.
15. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare,

studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor jomagjistrat.

16. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, nuk rezulton që kandidati znj. Lorana Kasapi të këtë ndjekur studime pasuniversitare brenda ose jashtë vendit (MND, Master profesional/Ekzekutiv, programet e studimeve të formimit të vazhduar etj, të barasvlershëm me to, në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”).
17. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me studimet pasuniversitare, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin znj. Lorana Kasapi me **0 (zero) pikë.**

#### **b.2 Gradat shkencore - (3/5) pikë**

18. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.
19. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor jomagjistrat.
20. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, nuk rezulton që kandidati Lorana Kasapi të këtë fituar brenda ose jashtë vendit grada shkencore në bazë të nenit 60, 61 dhe 79 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, (Dr, Phd, Prof apo Pro/asoc, Magjistraturë, etj).
21. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me gradat dhe kërkimin shkencor, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin znj. Lorana Kasapi me **0 (zero) pikë.**

### **b.3. Lista dhe lloji i trajnimeve - (1/5) pikë**

22. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Lorana Kasapi ka ndjekur disa veprimtari trajnimi afatshkurtra të dokumentuara, konkretisht:

- **Periudha : Korrik 2020**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Konventa Europiane për të Drejtat e njeriut.

Zbatimi praktik i lirive dhe të drejtave.

Emri dhe lloji i institucionit : Në kuadër të projektit “Europa respekton të drejtat e njeriut”, mbështetur nga Bashkimi European nëpërmjet programit IPA 2015, zbatuar nga Shoqata “Together for Life”

- **Periudha : 20-31 Maj 2019**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Kushtetuta, të Drejtat e Njeriut dhe parimet e funksionimit të Administratës.Procedurat Administrative.Komunikimi shkresor dhe hartimi shkresave.Etika dhe konflikti interesave. Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike. Menaxhimi i procesit të integritetit të Shqipërisë në BE. Informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”. E drejta e informimit. Aftësitë menaxhuese. Shërbimi civil në Shqipëri. Antikorrupsioni.

Emri dhe lloji i institucionit : Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

- **Periudha : Janar- Maj 2009**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Kushtetuta, të drejtat e Njeriut. Kodi Procedurës Administrative. Kodi Civil Kodi procedurës Civile Kodi Penal Kodi Procedurës Penale

E drejta Tregtare Kodi Familjes Procedura e Strasburgut

Emri dhe lloji i institucionit : Shkolla e Magjistraturës

- **Periudha : Janar- Maj 2009**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: “Procesi i përzgjedhës dhe kurset e trajnimit për Avokatët e Shtetit në periudhën janar – maj 2009”.Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Kushtetuta, të drejtat e Njeriut. Kodi Procedurës Administrative. Kodi Civil Kodi procedurës Civile Kodi Penal Kodi Procedurës Penale

E drejta Tregtare Kodi Familjes Procedura e Strasburgut

Emri dhe lloji i institucionit : Shkolla e Magjistraturës, Avokatura e Shtetit dhe Ambasada Spanjolle në Shqipëri.

**Periudha : 1-5 Korrik 1996**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: "Capital and Securities Market Investment"  
Emri dhe lloji i institucionit : Institut International De Droit DU Developpement.

23. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit "**Kualifikime Pasuniversitare**", që lidhet me trajnimet, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin znj. Lorana Kasapi me **1 (një) pikë**.

### **c. Njohja e gjuhëve të huaja - (3) pikë**

24. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se është njohës i gjuhës Frënge dhe asaj Angleze, të cilat i dëshmon përkatësisht me anë të dokumenteve: Dëshmi Vlerësimi lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ku është vlerësuar me notën 8 (tetë) dhe certifikata të niveleve "A2", "Preintermediate" dhe "Intermediate B1+" lëshuar nga Qendra e Gjuhëve të Huaja "Universi".
25. Për këto arsye, duke pasur parasysh dokumentacionin e administruar, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin znj. Lorana Kasapi për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **1 (një) pikë**.

### **B. Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional - (30) pike**

26. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", përcaktohet si kriter vlerësimi edhe kualifikimi i **përgjithshëm profesional**, përcaktohen si kriteret vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.
27. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale **prej 30 pikësh** sipas urdhrit nr. 7 referuar si më sipër, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të **një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin** dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor jomagjistrat.



28. Në rastin e kandidatit Lorana Kasapi, Komiteti shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e tij profesionale ndër vite, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të këtij kandidati në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

**a. Vlerësimi sasior - (5) pikë**

29. Për sa i përket **vlerësimit sasior**, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, rezulton se në dosjen e kandidimit është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm që ka të bëjë me aktivitetin profesional, kërkimin shkencor dhe publikimet nga ana e kandidatit znj. Lorana Kasapi:

- Prapësime nr., \_\_\_\_\_ prot, datë \_\_\_/10/2019, të përgatitura nga kandidati, më qëllim mbrojtjen e interesave procedurale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me çështjen administrative, ku ky subjekt ka qenë palë ndërgjyqëse ( i paditur), dhe Vendimi nr. 269, datë 31.01.2020 i dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës të Parë Tiranë, me gjyqtare Semeramis Hoxholli, që ka zgjidhur çështjen administrative, të sipërcituar, ku është vendosur rrëzimi i padisë (32 faqe);
- Parashtrësë e Avokaturës të Shtetit nr. \_\_\_\_\_ prot., datë \_\_\_/06/2017, përgatitur nga kandidati në çështjen civile për të cilën është depozituar Rekurs të në Gjykatën e Lartë kundër, vendimit nr. 383, datë 04.11.2008 të ZRKK Pronave Vlorë (12 faqe).
- Rekurs i Avokaturës të Shtetit nr. \_\_\_\_\_ prot., datë 15.12.2014, përgatitur nga kandidati në çështjen civile ku Këshilli i Ministrave ka qenë i paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë (26 faqe).
- Parashtrësë e Avokaturës të Shtetit nr. \_\_\_\_\_ prot., datë \_\_\_/02/2015, përgatitur nga kandidati në emër të Këshillit të Ministrave, lidhur me kërkesën e depozituar për shfuqizimin si antikushtetuese paragrafi i pestë i nenit 610 të K.Pr.Civile, me Kërkues: Avokati i Popullit dhe Gjykata e rrethit Gjyqësor Fier, para Gjykatës Kushtetuese (vendim nr. 30, datë 25.05.2015 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 10 faqe).
- Parashtrësë e Avokaturës të Shtetit nr. \_\_\_\_\_ prot., datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, përgatitur nga kandidati në emër të Këshillit të Ministrave, lidhur me kërkesën e depozituar për shfuqizimin si antikushtetuese të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohet ose ushtrojnë funksione publike”, me Kërkues: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, para Gjykatës Kushtetuese (vendim nr. 43, datë 05.06.2017 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë); (22 faqe)

30. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Komiteti vlerëson se në aspektin sasior kandidati Lorana Kasapi ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë dukshëm përtej asaj që mund të gjykohet si një

angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin znj. Lorana Kasapi për këtë kriter ligjor vlerësimi me 5 (pesë) pikë.

#### **b. Vlerësim cilësor - (25) pikë**

31. Për sa i përket **vlerësimit cilësor**, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Komitet dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit jomagjistrat.
32. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidati **Lorana Kasapi**, për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, ka paraqitur **pesë dokumentet profesionale** si më poshtë:
- Prapësime nr. \_\_\_\_\_ prot, datë \_\_\_/10/2019, të përgatitura nga kandidati, më qëllim mbrojtjen e interesave procedurale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me çështjen administrative, ku ky subjekt ka qenë palë ndërgjyqëse ( i paditur), dhe Vendimi nr. 269, datë 31.01.2020 i dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës të Parë Tiranë, me gjyqtare Semeramis Hoxholli, që ka zgjidhur çështjen administrative, të sipërcituar, ku është vendosur rrëzimi i padisë (32 faqe). Në këto akte procedurale kandidati znj. Lorana Kasapi, nëpërmjet një analize gjithëpërfshirëse të rrethanave të faktit dhe të ligjit, për sa i takon kërkesë –padië që është paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës të Parë Tiranë kundër Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që është në pozitë procedurale të palës të paditur, argumenton të gjitha shkaqet ligjore sepse duhet të vendoset rrëzimi i kërkesë-padië si e pabazuar në ligj dhe në prova. Në këtë akt procedural i dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës të Parë Tiranë, gjejnë pasqyrim argumentet dhe mënyra e mbrojtjes ligjore, që kandidati znj. Lorana Kasapi, realizoi gjatë gjykimit për palën e paditur Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku në fund të dispozitivit të vendimit gjyqësor të dhënë është vendosur rrëzimi i kërkesë-padië si e pabazuar në ligj dhe në prova.
  - Rekurs i Avokaturës të Shtetit nr. \_\_\_\_\_ prot., datë 15.12.2014, përgatitur nga kandidati në çështjen civile ku Këshilli i Ministrave ka qenë i paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë (26 faqe). Në këtë akt procedural në formën e Rekursit të përgatitur nga kandidati znj. Lorana Kasapi, në emër të Avokaturës të Shtetit, parashtrihen të gjitha argumentet ligjorë, para Gjykatës të Lartë, ku është kërkuara shfuqizimi i Vendimit nr. 3916, datë 23.10.2014 i

dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës të Parë Tiranë dhe vendimi Vendim nr. 269, datë 06.03.2014 i dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe rrëzimin e kërkesë-padisë.

- Parashtrësë e Avokaturës të Shtetit nr. \_\_\_\_\_ prot., datë \_\_\_\_/06/2017, përgatitur nga kandidati në çështjen civile për të cilën është depozituar Rekurs të në Gjykatën e Lartë kundër, vendimit nr. 383, datë 04.11.2008 të ZRKK Pronave Vlorë (12 faqe). Në këtë akt procedurale në formën e Parashtrësës të përgatitur nga kandidati znj. Lorana Kasapi, në emër të Avokaturës të Shtetit, parashtrohen të gjitha argumentet ligjor, para Gjykatës të Lartë, lidhur me kundërshtimin e vendimit nr. 383, datë 04.11.2008 të ZRKK Pronave Vlorë.
- Parashtrësë e Avokaturës të Shtetit nr. \_\_\_\_\_ prot., datë \_\_\_\_/02/2015, përgatitur nga kandidati në emër të Këshillit të Ministrave, lidhur me kërkesën e depozituar për shfuqizimin si antikushtetuese paragrafi i pestë i nenit 610 të K.Pr.Civile, me Kërkues: Avokati i Popullit dhe Gjykata e rrethit Gjyqësor Fier, para Gjykatës Kushtetuese (vendim nr. 30, datë 25.05.2015 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë ), (10 faqe). Në këtë akt procedural në formën e Parashtrësës të përgatitur nga kandidati znj. Lorana Kasapi, në emër të Avokaturës të Shtetit, parashtrohen të gjitha argumentet përkatës, kushtetues dhe ligjorë, para Gjykatës Kushtetuese, me qëllim mbrojtjen e interesave ligjore të Këshillit të Ministrave si Palë e Tretë, lidhur me çështjen kushtetuese që i përket Kërkues: Avokati i Popullit dhe Gjykata e rrethit Gjyqësor, për shfuqizimin si antikushtetuese paragrafi i pestë i nenit 610 të K.Pr.Civile, me Kërkues: Avokati i Popullit dhe Gjykata e rrethit Gjyqësor Fier.
- Parashtrësë e Avokaturës të Shtetit nr. \_\_\_\_\_ prot., datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_, përgatitur nga kandidati në emër të Këshillit të Ministrave, lidhur me kërkesën e depozituar për shfuqizimin si antikushtetuese të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohet ose ushtrojnë funksione publike”, me Kërkues: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, para Gjykatës Kushtetuese (vendim nr. 43, datë 05.06.2017 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë); (22 faqe). Në këtë akt procedural në formën e Parashtrësës të përgatitur nga kandidati znj. Lorana Kasapi, në emër të Avokaturës të Shtetit, parashtrohen të gjitha argumentet përkatës, kushtetues dhe ligjorë, para Gjykatës Kushtetuese, me qëllim mbrojtjen e interesave ligjore të Këshillit të Ministrave si Palë e Tretë, lidhur me çështjen kushtetuese që i përket Kërkues: Komiteti Shqiptar i Helsinkit për shfuqizimin si antikushtetuese pika 4 të nenit 2 të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohet ose ushtrojnë funksione publike”.

33. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati **Lorana Kasapi** dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor.(shtojca nr.2).

34. Dokumentet trajtojnë tematika në fushën e së drejtës në të cilën ka operuar ndër vite kandidati, përfshi ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ligjshmërisë së veprimtarisë administrative të organeve shtetërore, mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural në përmbushjen e detyrimeve të organit shtetëror si edhe të subjekteve dhe individëve në raport me të drejtat dhe detyrimet përkundrejt **organit shtetëror kompetent**. Në Platformën që ka depozituar kandidati znj. Lorana Kasapi, si dhe pesë dokumentet e sipërcituar në kuadrin e vlerësimit profesional, spikat aftësia profesionale për të përgatitur akte procedurale sikurse janë parashtrirat, prapësimet, konkluzionet, aktet e rekursit dhe ankimet e përgatitura nga kandidati ka depozituar në emër të Avokaturës të Shtetit, para Gjykatës Administrative të shkallës të Parë Tiranë, Gjykatës të Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, janë një pjesë e punës profesionale që kandidati ka përmbushur, gjatë kohë që ka shërbyer pranë Avokaturës të Shtetit.
35. Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe Platforma e paraqitur nga vetë kandidati znj. Lorana Kasapi, për sa më sipër si dhe intervista e zhvilluara me të nga ana e Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, vlerësimi i këtyre të dhënave bëhet në pesë komponentë kryesorë që janë, origjinaliteti dhe/ose impakti i veprimtarisë profesionale të kandidatit, aftësitë analitike, aftësitë kërkimore, saktësia dhe precizoni, si dhe qartësia.

#### **b/1. Origjinalitet dhe/ose impakti - (6) pikë**

36. Njëri nga indikatorët vlerësues të dokumenteve profesional është vlerësues të dokumenteve profesionalë është "**Origjinaliteti dhe/ose impakti**". Nisur nga profili profesional i kandidatit Lorana Kasapi, përmbajtja e dokumenteve të analizuarra dhe dobisë së tyre nga profesionistë të fushës apo grupeve të interesit, Komiteti vëren se dokumentacioni i paraqitur ofron një panoramë të elementëve të një qasje profesionale origjinale në trajtimin e çështjeve ligjore para Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë Tiranë, Gjykatës të Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë krahas disa elementëve të origjinalitetit në përmbushjen e detyrës për aq sa e lejon natyra e funksionit publik të ushtruar duke sjellë argumente në dobi të punës në të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor si dhe atë të Gjykatës Kushtetuese.
37. Për rrjedhojë pas shqyrtimit të dokumentacionit, në zërin "**Origjinaliteti dhe impakti**", Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

#### **b/2. Aftësitë analitike - (6) pikë**

38. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me "**Aftësitë analitike**", Komiteti duke u përqendruar në vendimet e gjykatës arrin në konkluzionin se parashtrimet e bëra nga kandidati tregojnë dhe

dëshmojnë zotërimin e aftësisë profesionale të kandidatit për të arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore në fushën e operimit.

39. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit të analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me zërin “Aftësitë analitike”, Komiteti vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë.**

**b/3. Aftësitë kërkimore - (4) pikë**

40. Në lidhje me treguesin “**Aftësitë kërkimore**”, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin profesional të paraqitur nga kandidati.
41. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “Aftësitë kërkimore”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 (dy) pikë.**

**b/4. Saktësia dhe precizioni - (5) pikë**

42. Referuar kriterit “**Saktësia dhe precizioni**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur duke shmangur përsëritjet në material. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të mjaftueshëm të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike.
43. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Saktësia dhe precizioni**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë.**

**b/5. Qartësia - (4) pikë**

44. Referuar kriterit “**Qartësia**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët e kanë strukturuar tematikën dhe problemin duke qartësuar gjuhën dhe duke përdorur në mënyrë të kënaqshme terminologjinë profesionale. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të kuptueshëm të parashtrimeve.
45. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Qartësia**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë.**
46. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, që përbëjnë **vlerësimin cilësor** të kandidatit, Komiteti vendosi të vlerësojë kandidatin me **14 (katërmëdhjetë) pikë.**

### **C. Kualifikim shtesë profesional - (10) pikë**

#### **a. Përvoja dhe cilësia profesionale e posaçme për rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së - (7) pikë**

47. Rezultatet profesionale në lidhje me këtë kriter vlerësimi, shqyrtohen nga Komiteti për të vlerësuar veçanërisht rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojat e veçanta profesionale të kandidatit të cilat tregojnë vlera të spikatura profesionale në shërbim të drejtimit, organizimit dhe funksionimit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe të ushtrimit të kompetencave të këtij institucioni, përfshirë këtu vlerësimin e njohurive të posaçme profesionale në lidhje me ushtrimin e kompetencave të kontrollit, inspektimeve, hetimeve disiplinore si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji.
48. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 10 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Komiteti, vlerëson deri në 7 pikë ekspertizën në fushat e së drejtës dhe posaçërisht në çështjet e drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe ushtrimit të kompetencave me natyrë kontrolli, inspektimi, hetimi disiplinor si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Gjithashtu, Komiteti vlerëson deri në 3 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara urdhrin nr. 7 (si më sipër) të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.
49. Veprimtaria profesionale që kandidati znj. Lorana Kasapi, ka ushtruar si Këshilltare pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Specialiste në Drejtorinë Juridike pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokate Shteti në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit pranë Zyrës së Përfaqësimit ligjor në Gjykatat Kombëtare, Avokate Shteti në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektimit në Avokaturën e Përgjithshme, Avokate Shteti pranë Ministrisë së Integritimit, Avokate Shteti pranë Zyrës Vendore Tiranë, Kryetare Departamentit Juridik/specialiste në Departamentin Juridik, Shoqëria Albtelecom sh.a. është një veprimtari që ka lidhje me rolin dhe veprimtarinë e Inspektorit të lartë të Drejtësisë.
50. Parashtrësat/prapësimet/konkluzionet aktet e rekursit dhe ankimeve të përgatitura nga kandidati znj. Lorana Kasapi, ka depozituar në emër të Avokaturës të Shtetit, para Gjykatës Administrative të shkallës të Parë Tiranë, Gjykatës të Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, janë një pjesë e punës profesionale që kandidati ka përmbushur, gjatë kohë që ka shërbyer pranë Avokaturës të Shtetit.

51. Lidhur me këtë kriter, Komiteti pasi shqyrtoi dokumentet profesionale të depozituara në dosjen e kandidimit dhe të analizuar më sipër lidhur me rëndësinë që ato mbartin, të dhënat e jetëshkrimit, si dhe intervistën e zhvilluar dhe motivimin për kandidim, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për kriterin e “Përvojës dhe cilësisë profesionale që a ka ushtruar në raport me rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së”, e vlerëson kandidatin znj. Lorana Kasapi **4 (katër) pikë.**

#### **b. Angazhime profesionale shtesë - (3) pikë**

52. Nga aktet e dosjes dhe nga vetëdeklarimet e kandidatit Lorana Kasapi, rezulton se ka paraqitur angazhime shtesë profesionale, sikurse është zotërimi i licencës së ushtrimit të profesionit të avokatit në sektorin privat si dhe licencës të ushtrimit të profesionit të Avokatit të Shtetit nga Ministria e Drejtësisë.

- **Periudha :2009**

Lloji i titullit/ fusha profesionale : Avokat me nr. 3790 Licence;

Emri dhe lloji i institucionit që ka dhënë titullin : Dhoma Kombëtare e Avokatëve të Shqipërisë.

- **Periudha: Maj 2009**

Lloji i titullit/ fusha profesionale: Avokat Shteti.

Emri dhe lloji i institucionit që ka dhënë titullin : Avokatura e Shtetit, Ministria e Drejtësisë.

53. Duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trajnuese të ndjekura nga kandidati **Lorana Kasapi**, për këtë kriter ligjor vlerësimi Komiteti çmoi ta vlerësojë me **1 (një) pikë.**

54. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë merita profesionale dhe kualifikim shtesë profesional, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **5 (pesë) pikë.**

## **2. MERITA MORALE, ORGANIZATIVE, DREJTUESE DHE MENAXHERIALE - (50) pikë**

### **2/1. Merita morale - (25) pikë**

55. Si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për integritet të lartë moral dhe profesional. Konkretisht përcaktohen si kriterë vlerësimi edhe "*Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegeve*" dhe "cilësi morale të tilla si: Ndershmëria, përpikëria, drejtësia në

marrjen e vendimeve dhe ushtrimin e detyrave” si edhe "angazhimi i provuar ne ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”.

56. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikesh për të tre komponentët vlerësues, Komiteti vlerëson deri në 15 pikë integritetin etik dhe moral, deri në 8 pikë reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve dhe deri në 2 pikë angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

57. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Komitetin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës. Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të këtij kandidati.

**a. Integriteti etik e moral - (15) pikë.**

58. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, integritetit etik e moral, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon përkushtim dhe angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje, ndjeshmëri dhe respekt ne komunikim e bisedë, duke parashtruar argumentet e tij me kompetence, dinjitet, duke dëgjuar dhe përgjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërmbytje përkundrejt qëndrimeve dhe pyetjet të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.

59. Nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Komitetit nuk i rezulton që kandidati të ushtrojë apo të ketë ushtruar funksionet e tij profesionale duke favorizuar palë të caktuara apo duke kërkuar përfitime për veten apo për të tjerët. Nuk rezultojnë të dhëna që ky kandidat të mos ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, të ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me koleget, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune etj. Pra nuk ka të dhëna që me sjelljen dhe veprimtarinë e tij në jetën profesionale dhe personale të ketë cenuar apo të rrezikojë të cenojë imazhin dhe figurën publike të nëpunësit shtetëror dhe sistemit të drejtësisë.

60. Prandaj, ne lidhje me kriterin vlerësues të "*integritetit etik e moral*", Komiteti e vlerëson kandidatin me **15 (pesëmbëdhjetë) pikë.**



## **b. Reputacioni në shoqëri dhe midis kolegëve - (8) pikë**

61. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve", nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim. Intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati me veprimtarinë dhe sjelljen në shoqëri, tregon angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave për zbatimin e drejtë të ligjit në ushtrimin e kompetencave që i ngarkon ligji.
62. Në lidhje me vlerësimin e punës dhe reputacionin që kandidati znj. Lorana Kasapi gëzon, rezulton se pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kandidati ka dorëzuar Rekomandim nr. 1502 prot., datë 28.10.2021 lëshuara nga z. Robert Gajda në cilësinë e drejtuesit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që ka pasur mundësinë të ketë si punonjës të këtij institucioni kandidatin, që venë në dukje cilësitë e saj etiko-profesionale.
63. Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarinë e tij përmbush të gjitha pritshmëritë e aspektit moral për marrjen e përgjegjësisë ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmërinë e publikut për gëzimin e cilësive profesionale e morale për ushtrimin e detyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me kriterin vlerësues "të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve", Komiteti e vlerëson kandidatin me **7 (shtatë) pikë.**

## **c. Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile - (2) pikë**

64. Për sa i përket kriterit të vlerësimit që lidhet me angazhimin në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se, përgjithësisht, kandidati nuk ka qenë i angazhuar në veprimtari të tjera të përshtatshme jashtë atyre të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.
65. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "**Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile**", Komiteti e vlerëson kandidatin me **0 (zero) pikë.**
66. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave morale, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **22 (njëzetedy) pikë.**

## **2/2. Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale - (25) pikë**

67. Ky komponent zërthehet në disa nën komponentë të tjerë, konkretisht:

- a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;
  - b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
  - b. aftësitë e komunikimit;
  - c. aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
  - d. aftësitë e përfaqësimit publik."
68. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kriteret vlerësimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" ku përcaktohen rregullime me të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.
69. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 25 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Komiteti vlerëson deri në 8 pikë cilësinë e platformës dhe vizionin që paraqesin kandidatet, deri në 10 pikë aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore, deri në 5 pikë aftësisë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik, si edhe me 2 pikë për aftësitë e të punuarit në grup dhe ambiente multidisiplinore.
70. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" dhe Shtojcën nr. 2 të tij si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidateve për inspektor.
71. Komiteti shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës dhe arsytet apo motivet e kandidimit dhe vizionit të kandidatit lidhur me qasjen dhe qëndrimet e tij mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së Inspektorit, mbi sfidat kryesore me të cilat duhet të përballë Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e përgjegjësisë dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji, si edhe lidhur me mendimet e kandidatit për çështjet që duhet të trajtohen me përparësi e në perspektivë për mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e këtij institucioni të ri dhe shumë të rëndësishëm kushtetues, për ushtrimin efektiv dhe me nivel të lartë profesional e besueshmërie të kompetencave të tij në funksion të ndërtimit të një sistemi drejtësie të bazuar në integritetin profesional e moral, nisur edhe nga pritshmëritë e jashtëzakonshme të publikut pas miratimit dhe vënies në zbatim të reformës në drejtësi. Gjithashtu, në vlerësimin e

këtij kriteri, Komiteti mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga ky kandidat gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Komitetit.

**a. Cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqet kandidati - (8) pikë**

72. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Komiteti vëren se kandidati paraqiti një nivel mesatar të njohjes dhe përvojës profesionale së saj në lidhje me rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të inspektorit jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe elemente premtues që tregojnë cilësi, thellësi dhe origjinalitet për sa i përket sfidave me të cilat do të përballet kandidati, objektivat për çështjet e organizimit dhe funksionimit cilësor dhe efektiv të institucionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke vënë theksin të pavarësia e tij, respektimi i procesit të rregullt ligjor, zhvillimi i marrëdhënieve me publikun.
73. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “Cilësia e platformës dhe vizionit të paraqitur” nga kandidati, Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë.**

**b. Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale shoqërore - (10) pikë**

74. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Komiteti mbështetet pikësëpari në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësisë dhe ushtrimin e vendimmarrjes në përmbushjen e kompetencave dhe të detyrave të ngarkuara, veçanërisht për aspektet e drejtimit dhe të administrimit të punëve. Në këtë drejtim, Komiteti shqyrton dhe vlerëson posaçërisht aftësitë e provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësitë si edhe për të marrë vendimet e duhura në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.
75. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në interviste, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit. Për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
76. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **5 (pesë) pikë.**

**c. Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik - (5) pikë**

77. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me nëpunësit dhe punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me organet e tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe përfaqësuesit e tyre, me gjyqtarët dhe prokurorët, sikurse edhe në komunikimin dhe përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jodiskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
78. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë si dhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësi të mjaftueshme për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për t'u përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, me stil dhe gjuhë të pasur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.
79. Gjithashtu referuar prezantimit të bërë gjatë intervistës, rezulton se ky kandidat zotëron edhe aftësi të mira për përfaqësimin publik, prezanton thjeshtësi, aftësi për të shprehur bindjet e tij me vetëbesim. Kandidati transmeton besueshmëri gjatë komunikimit dhe aftësi për t'u përgjigjur me etikë.
80. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik", Komiteti e vlerëson kandidatin me **5 (pesë) pikë.**

**d. Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale - (2) pikë**

81. Inspektori për vetë natyrën e këtij institucioni dhe funksioni, duhet të zotëroje aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të organizuar dhe për të qenë i përfshirë në punën në grup, me nëpunësit dhe punonjës të Zyrës dhe për aq sa kërkohet dhe nevojitet me funksionarë e përfaqësues të institucioneve të tjera dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për tu përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.
82. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti

vëren se kandidati zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup, përfshirë atë për të punuar në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore.

83. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore”, Komiteti vlerëson t’i caktojë kandidatin **2 (dy) pikë.**

84. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **16 (gjashtëmbëdhjetë) pikë.**

### **III - Vlerësimi përfundimtar i kandidatit**

85. Në përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar me sipër në këtë vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së Inspektorit jomagjistrat dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për këtë vend vakant, Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i rezulton se kandidati znj. Lorana Kasapi vlerësohet në total **66 (gjashtëdhjetegjashtë) pikë.**

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

### **VENDOSI:**

1. Vlerësimin e kandidatit Lorana Kasapi, me **66 (gjashtëdhjetegjashtë) pikë,** në lidhje me kandidimin e tij për vendin vakant inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.

2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Lorana Kasapi.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”.

**KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE**

**ANËTAR**

**Julian Zonja**

**KRYETAR**

**Besnik Maho**

**ANËTAR**

**Joana Asimi**

